

Akademisa e Integritetit të Informacionit

“Konferenca për
gazetarët e rinj”



Konferenca për gazetarët e rinj

1. Hyrje

Duke e pasur edhe numrin më të lartë të popullësisë së re në rajon, Kosova ka numrin më të madh të gazetarëve të rinj me rreth 80 % të tyre 18 deri 44 vjec. Kjo e bën skenën mediale të Kosovës shumë vibrante, por përvec përparësive i ka edhe disa mangësi.

Në diskutimin përmbajtësor gazetarët e rinj, dhe ata me pak më shumë përvojë i ndanë përvojat e tyre të fillimit të punës, vështirësitë për t'u adaptuar dhe rrugët më të përshtatshme për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme në një peisazh vazhdimisht të ndryshueshëm mediatik në Kosovë.

2. Përparësitë:

- Gazetarët e rinj në vitet e fundit e kanë përparësinë e mundësisë së zgjedhjes se ku duan të punojnë, për shkak të shtimit shumë të madh të medieve që veprojnë.
- Duhet përgatitje të ndryshme për shkrime dhe për video, dhe janë më të prirë që të mësojnë, dhe të orientohen edhe nga përvoja e kolegëve me më shumë përvojë të punës brenda redaksive ku punojnë.
- Vullneti i madh për të punuar me përkushtim për arritjen e objektivave në karrierë, duke përfshirë edhe oraret e gjata, dhe punën në fundjavë.

3. Mangësitë:

- Mungesa e besimit tek gazetarët e rinj për t'u dhënë detyra të rëndësishme për të raportuar. Duhet kaluar një kohë më e gjatë, që një gazetarëje/ai t'i jepet mundësia për të raportuar, ndjekur e hulumtuar temat më me rëndësi të politikës dhe çështjeve tjera sociale në Kosovë.
- Shumë prej gazetarëve punojnë duke vazhduar ende studimet, dhe kjo paraqet problem edhe që puna në redaksi të jetë më efektive, por edhe që provimet dhe të tjera obligime me fakultetin ku studiojnë të menaxhohen në mënyrën më të mirë.
- Lehtësia e ndryshimit të politikave në vendin e punës con edhe deri tek largimi i gazetarëve të rinj, dhe kjo krijon një pasiguri për gazetarët që duhet të ndryshojnë shpesh vendin e tyre të punës.

- Puna, ndonjëherë disa mujore pa pagesë, si një lloj shfrytëzimi i gazetarëve, është praktikë në shumë media. Sado që gazetarët e shohin mundësinë për të punuar në një medie, sidomos ato të etabluara, mospagesa për punën e bërë është trend negativ dhe i papranueshëm.

4. Rekomandimet

- Më shumë trajnime për të rinjtë për fusha të ndryshme, në mënyrë që të marrin njohuri shtesë, përtej asaj që e mësojnë për punën praktike në tematika të ndryshme.
- Profilizim i hershëm i gazetarëve në karrierë, në mënyrë që ata të jenë më të suksesshëm dhe më të dobishëm në punën që e bëjnë
- Puna e vërtetë praktike në media të bën të kuptish që ajo që mëson në teori . Krijimi i përvojës së punës qoftë disa mujore ndihmon për të pasur prospekte më të mira në karrierë, në mënyrë që në të ardhmen të sigurohet vend pune me më shumë mundësi, duke përfshirë ato financiare
- Ngritja e zërit herët për trajtimin në vendin e punës, sidomos për gratë gazetare, dhe lajmërimi i rasteve të largimit të paligjshëm nga puna, në Inspektoratin e Punës.